

Statistikat e Transportit Detar

Tremujori II, 2024

Tiranë, më 30 Korrik 2024: Në Shqipëri operojnë katër porte detare të cilët shërbejnë për transport mallrash: Porti i Durrësit, Vlorës, Shëngjinit dhe porti i Limjonit (Sarandë). Porti i Durrësit është porti kryesor në vend prej të cilit, gjatë tremujorit të dytë 2024, janë transportuar 94,9 % e volumit të mallrave të transportuar me det, ose 2.034 mijë ton mallra. Volumi gjithsej i mallrave të transportuara nga porti i Durrësit është rritur me 26,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab.1: Volumi i mallrave sipas porteve detare, 000/ton

Mallra 000/ton	TR II – 2022	TR III – 2022	TR IV – 2022	TR I – 2023	TR II – 2023	TR III – 2023	TR IV - 2023	TR I - 2024	TR II - 2024
Portet	1.540	1.686	1.597	1.619	1.713	1.688	1.739	1.673	2.142
Durrës*	1.473	1.619	1.526	1.553	1.608	1.618	1.641	1.606	2.034
Import	1.037	1.337	1.216	1.237	1.257	1.303	1.254	1.280	1.634
Eksport	436	282	310	316	351	315	387	326	400
Vlorë	28	27	30	19	30	37	44	38	44
Import	17	17	18	10	20	25	33	31	34
Eksport	11	10	12	9	10	12	11	7	10
Sarandë (Limjoni)	11	7	9	13	31	4	10	9	10
Import	8	4	6	8	12	4	10	9	10
Eksport	3	3	3	5	19	0	0	0	0
Shëngjin	28	33	31	33	44	29	44	20	54
Import	12	17	19	23	36	17	32	13	35
Eksport	16	16	12	10	8	12	12	7	19

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje INSTAT

*Në të dhënat e Portit të Durrësit përfshihet edhe volumi i mallrave të transportuara nga Porti koncensionar i Porto Romanos

Llojet e grup-mallrave kryesore të transportuara nëmjet rrugëve detare sipas klasifikimit, NST 2007 (Nomenclatura e Statistikave të Transportit), për tremujorin e dytë 2024 paraqiten si më poshtë:

- Grupi "Koks dhe produktet e rafinuara të naftës" përbën 17,2 % të mallrave të transportuara nga portet;
- Grupi "Produkte të tjera minerale (jo metalike)" përbën 14,2 % të mallrave të transportuara;
- Grupi i mallrave "Metale bazë; produkte metalike të fabrikua, përveç makinerive dhe pajisjeve" përbën 11,2 % të mallrave të transportuara;
- Grupi i mallrave "Qymyr dhe linjit; naftë bruto dhe gaz natyror" përbën 9,0 % të mallrave të transportuar.

Për publikim 30/07/2024

Tab. 2: Transporti detar i mallrave sipas kategorive të NST 2007

Nr	Kategoritë e mallrave të transportuara sipas NST*	Mallra gjithsej në ton	
		Tr II - 2023	Tr II - 2024
	Gjithsej	1.712.710	2.142.331
1	Produktet bujqësore, gjuetisë, pyjeve dhe peshku dhe produktet e tjera të peshkimit	3.592	13.074
2	Qymyr dhe linjit; naftë bruto dhe gaz natyror	87.864	192.006
3	Produktet metalike dhe të minierave dhe produkte të tjera të guroreve; torfe; uranium dhe torium	37.707	15.606
4	Produkte ushqimore, pijeve dhe duhanit	37.467	36.243
5	Tekstile dhe produkte tekstili; lëkurë dhe produkte lëkure	625	654
6	Druri dhe produktet e drurit dhe produktet me tapë (përveç mobilie); artikujt prej kashte dhe materialeve thurës; pulpë, letër dhe produkte letre; materialet e shtypura dhe mediat e regjistruara	19.223	21.070
7	Koks dhe produktet e rafinuara të naftës	244.164	369.364
8	Kimikate, produkte kimike, dhe fibra të bëra nga njeriu; produkte gome dhe plastike, karburant bërthamor	16.353	31.340
9	Produkte të tjera minerale (jo metalike)	179.817	305.052
10	Metale bazë; produkte metalike të fabrikua, përveç makinerive dhe pajisjeve	262.131	240.885
11	Makineri dhe pajisje; Pajisje zyre dhe kompjuter; makineri elektrike dhe aparatura si radio, televizion dhe pajisjet e komunikimit; instrumentet mjekësorë dhe orë	807	41
12	Pajisje transporti	363	5.248
13	Mobilie; mallra të tjerë të përpunuar të p.k.v	0	0
14	Lëndë të para të ricikluara; Mbetjet e ngurta (bashkiake) dhe mbeturinat e tjera	8.099	8.254
15	Pako postare	0	0
16	Pajisje dhe materiale që përdoren në transportin e mallrave	34.879	37.363
17	Mallra të lëvizura në rrugën e zhvendosjes së familjeve dhe zyrave; bagazheve të transportuara të ndara nga ato të udhëtarëve; automjetet të transportuara për riparim; mallra jo tregtare të tjera.	0	0
18	Mallra të grupuara: një përzierje e llojeve të mallrave të cilat janë transportuar së bashku	9.284	11.346
19	Mallra të paidentifikuara: mallrat që për ndonjë arsye nuk mund të identifikohen dhe për këtë arsye nuk mund të caktohet në grupe 01-16.	770.335	854.786
20	Mallra të tjera të p.k.v	0	0

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje INSTAT

*Volumi i mallrave të transportuar me det përfshin mallrat e transportuar me anije dhe traget

Numri i anijeve të hyra dhe të dala nga portet në vend rezulton 251 anije, nga këto 218 anije janë të huaja dhe 33 anije vendase. Numri i anijeve të hyra dhe të dala në porte është rritur me 79,3 %, ku numri anijeve të huaja është rritur me 2 herë, krahasuar me tremujorin e dytë 2023.

Portet detare ku kryhet transporti pasagjerëve në vend janë: Porti i Durrësit, Vlorës, Sarandës dhe porti i Shëngjinit. Lëvizja e pasagjerëve në tremujorin e dytë 2024 është kryer nga porti i Durrësit, Vlorës dhe porti i Sarandës.

Tab. 3: Transporti Detar i pasagjerëve

Pasagjerë	TR II – 2022	TR III – 2022	TR IV – 2022	TR I – 2023	TR II – 2023	TR III – 2023	TR IV - 2023	TR I - 2024	TR II - 2024
Portet gjithsej	222.991	825.290	197.378	138.242	280.914	988.241	197.377	135.680	298.175
Porti Durrës	121.336	445.712	133.669	109.961	129.218	461.070	127.603	109.722	117.200
Hyrje	63.853	210.026	78.253	41.615	69.780	221.357	77.087	43.203	62.561
Dalje	57.483	235.686	55.416	68.346	59.438	239.713	50.516	66.519	54.639
Porti Vlorë	28.082	124.051	31.671	21.638	23.370	147.570	20.581	15.765	25.355
Hyrje	14.534	57.847	18.073	9.241	12.944	70.412	12.303	6.600	13.444
Dalje	13.548	66204	13.598	12.397	10.426	77.158	8.278	9.165	11.911
Porti Sarandë (Limjoni)	73.573	255.527	32.038	6.643	128.326	379.601	49.193	10.193	155.620
Hyrje	37.075	126.166	15.820	3.299	65.277	186.302	24.440	4.875	77.741
Dalje	36.498	129.361	16.218	3.344	63.049	193.299	24.753	5.318	77.879
Porti Shëngjin	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Hyrje	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Dalje	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje INSTAT

Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar nëpërmjet porteve detare në vend është 298.175 persona.

Porti i Sarandës është porti nga i cili kanë udhëtuar 52,2 % e pasagjerëve, ndjekur nga porti i Durrësit me 39,3 % dhe më pas porti i Vlorës me 8,5 %.


Eksportet/importet e mallrave me det

Në tremujorin e dytë 2024, volumi i mallrave të tregtuara me det (eksport dhe import) është 1.546,3 mijë ton. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023, ky tregues është rritur me 16,1 %.

Volumi i mallrave të eksportuara me det në tremujorin e dytë 2024 zë 40,6 % ndaj totalit të volumit gjithsej të mallrave të eksportuara.

Volumi i mallrave të importuara me det në tremujorin e dytë 2024 zë 64,9 % ndaj totalit të volumit gjithsej të mallrave të importuara.

Fig. 1: Eksport/import i mallrave me det, ton



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Ilogaritje INSTAT

Metodologjia

Publikimi i Statistikave të Transportit paraqet rezultatet mbi transportin e mallrave dhe pasagjerëve si dhe eksportin dhe importin e mallrave sipas mënyrës së transportit në frekuencë tremujore. Të dhënat janë administrative. Burimi kryesor i informacionit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Përkufizime

Transport: Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit hekurudhor, tokësor, detar dhe ajror.

Transport detar: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur mjete lundruese detare në udhëtime të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me det.

Port statistikor - Një port statistikor përbëhet nga një ose më shumë porte, të kontrolluara normalisht nga një autoritet i vetëm porti, në gjendje të regjistrojë lëvizjet e anijeve dhe ngarkesave.

Porti i ngarkimit - Quhet porti ku mallrat ngarkohen në anije dhe transportohen prej saj.

Porti i shkarkimit - Quhet porti ku mallrat janë shkarkuar nga anija pasi janë transportuar prej saj.

Transport ndërkombëtar detar - Quhet transporti detar mes dy porteve i lokalizuar në dy vënde të ndryshme.

Pasagjerë detar - Çdo person që kryen një udhëtim në det në një anije tregtare.

Pasagjerë të embarkuar (të dalë) - Janë pasagjerë të cilët kanë hipur në anije dhe transportohen prej saj.

Pasagjerë të disembarkuar (të hyrë) - Janë pasagjerë të zbritur nga anija pasi janë transportuar prej saj.

Pasagjerë/kilometër - Njësia e matjes që përfaqëson lëvizjen e një pasagjerinë një anije tregtare mbi një kilometër.

Eksportet: Janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i katërt, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Importet: Janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i katërt, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007): Është një nomenklaturë statistikore e cila përdoret për mallrat e transportuara nëpërmjet katër mënyrave të transportit: transport rrugor, hekurudhë, transport ujor i brendshëm dhe transport detar.

Të dhënat e transportit detar janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë, referohu.

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë

(...) mungesë të dhënash